



REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Emri Grupe Drejtoria Adresa Nr. postorik	DPK 01/2300/13 30.07.13



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

DATE/A:	30/07/2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z.Xhevat SIMNICA Drejtor i Prokurimit në Komunën e Prishtinës
CC:	z.Isa MUSTAFA Kryetar i Komunës së Prishtinës
NGA/OD/FROM:	z.Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion për Tenderin "Furnizim me Kamion për mbeturina"



Të nderuar!

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Furnizim me Kamion për mbeturina", me nr. të prokurimit: 616-13-136-111, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

**OPINION**

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Furnizim me Kamion për mbeturina" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 - L/042 për Prokurimin Publik.

## A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit e Komunës së Prishtinës ka përgatitë “Njoftim Kontrate” me titullin: “Furnizim me Kamion për mbeturina” me nr. prokurimi: 616-13-136-111, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-ës më 15/07/2013, në Procedurë të Hapur.

Në “Njoftim Kontrate” të publikuar në KRPP më datë 15/07/2013, tek pika III.2.4 e rubrikës “Kapaciteti teknik dhe profesional”, pika 4 ku thuhet se: Kamioni të jetë prodhim Evropian apo Amerikan apo sipas standardeve evropiane me vollan në krahun e majtë”, nuk është në përputhshmëri me rregullat e prokurimit.

Specifikimet Teknike që duhet t’i përmbahen Operatorët Ekonomik, janë të specifikuara në atë mënyrë që favorizon Operator Ekonomik të caktuar që kanë mundësi të sjellin Kamionin nga Evropa ose nga Amerika.

Me caktimin e vendit të origjinës së pajisjes, mund të favorizohet ndonjë operator ekonomik dhe të diskriminohet ndonjë tjetër. Bazuar në legjislacionin e vendit dhe ligjeve në fuqi, një gjë e tillë nuk është e lejuar dhe nuk i jep hapësirë konkurrencës së lirë dhe legale.

Parregullsi gjithashtu janë vënë re edhe tek Planifikimi i Prokurimit i vitit 2013 i Komunës së Prishtinës, i cili nuk është i kompletuar sa duhet me informacione ose nuk është sjellë i kompletuar në Agjencinë Kundër Korrupsion.

Konsiderojmë se një shkelje e tillë, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë që bien ndesh me Nenin 7. Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi; nenin 8 Planifikimi i Prokurimit; nenin 27 Dosja e Tenderit; dhe, nenin 28 Specifikimet teknike

Me respekt!

